



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM/KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. i dokumentit 20.2.1-2008-08

**RAPORT FINAL I AUDITIMIT TË PASQYRAVE FINANCIARE
TË ZYRËS SË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2008**

Prishtinë, 27 Korrik2009

Tabela e përmbajtjes

- I. Përmbledhje e përgjithshme
- II. Hyrje
- III. Gjendja e rekomandimeve nga vitet e kaluara
- IV. Fushëveprimi i auditimit
- V. Qasja e auditimit
- VI. Opinioni i auditimit
- VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

Shtojcat:

- I. Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit (ISSAI 400)
- II. Komentet e ZPRK dhe Përgjigjja e ZAP-it ndaj Komenteve

Lista e shkurtesave dhe fjalëve

AP	Auditori i Përgjithshëm
BKK	Buxheti i Konsoliduar i Kosovës
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
LMFPP	Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZPRK	Zyra e Presidentit të Republikës së Kosovës

I. Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), ka kryer auditimin e Pasqyrave Financiare të Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2008.

Auditimi jonë është kryer, në përputhje me standardet ndërkombëtare të auditimit të hartuara, nga INTOSAI dhe ka përfshirë testet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme, për të dhënë një opinion lidhur me pasqyrat financiare.

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Si theksim i çështjes Regjistri i Pasurive jo financiare nuk është shpalosur në pasqyra financiare (**ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes**)

Auditimi i kryer ka rezultuar në të gjeturat dhe rekomandimet si në vijim:

1. Regjistrat e pasurive nuk janë të kompletuara dhe të azhurnuara
2. Menaxhim i dobët i kontrollit të brendshëm lidhur me shpenzimet dhe
3. Nuk është respektuar në tersi LPP për disa nga aktivitetet e prokurimit, përzgjedhja e operatorëve ekonomik bëhet në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme.

Rekomandimi ynë kryesor është që, Sekretari i përhershëm duhet të ofroj një program efikas të kontrollit të brendshëm nën udhëheqjen e tij.

II. Hyrje

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm është sipas ligjit përgjegjëse për kryerjen e auditimeve vjetore të rregullsisë.

Auditimi i Rregullsisë është definuar si verifikim i kontabilitetit financiar, duke përfshirë ekzaminimin dhe vlerësimin e deklaratave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe dhënien e mendimeve:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;

- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm;
- Për ndershmërinë dhe drejtësinë e vendimeve administrative që mirren nga institucioni ose subjekti që i është nënshtuar auditimit; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin;

Është përgjegjësi e Zyrës së Presidentit të Republikës së Kosovës (ZPRK) të përgatisë pasqyrat financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (SNKSP), për “Raportimin financiar në bazë të kontabilitetit të parasë së gatshme”, në përputhje me Udhëzimin Administrativ 2008/13, dhe ato ti prezantoj me kohë.

III. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Raporti ynë i auditimit të Pasqyrave Financiare të vitit 2007 kishte dhënë 6 rekomandime. Nga këto, 2 janë zbatuar plotësisht, ndërsa të tjerat janë zbatuar pjesërisht.

Moszbatimi i plotë i rekomandimeve tona tregon se dobësitë e raportuara më herët nuk janë evituar plotësisht.

IV. Fushëveprimi i auditimit

Ky auditim i ZPRK ka të bëjë me pasqyrat financiare për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2008.

Objektivi primar i këtij auditimi ishte që t’i mundësohet ZAP të shpreh opinionin e saj nëse pasqyrat financiare të ZPRK, japin një pasqyrë të vërtet dhe të drejtë dhe nëse regjistrat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me Ligjet dhe rregulloret aplikative.

V. Qasja e auditimit

Auditimi ynë është planifikuar dhe realizuar gjatë periudhës prej 3 Dhjetori 2008 deri më 23 shkurt 2009, në bazë të Standardeve të Auditimit të INTOSAI-it.

Me qëllim të përmbushjes së përgjegjësiave tona, ne:

1. Kemi rishikuar pasqyrat financiare të ZPRK në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2008

2. Kemi përcaktuar nëse pasqyrat financiare të ZPRK janë përgatitur në pajtim me SNKSP "Raportimi Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme".
3. Kemi kryer teste substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
4. Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
5. Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit, 5% për paqartësitë dhe 3% për gabimet, si prag për lehtësimin e përcaktimit të llojit të opinionit që duhet dhënë mbi pasqyrat financiare;
6. Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare;
7. Kemi vlerësuar pavarësinë dhe cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm në ZPRK, për të përcaktuar nëse mund të mbështetemi në punën e tyre për qëllimet e auditimit tonë;

Të gjeturat dhe konkluzionet tona të auditimit bazohen në dokumentacionin, informatat dhe shpjegimet të cilat na janë dhënë gjatë punës sonë të auditimit.

Lidhur me opinionin tonë të auditimit për pasqyrat financiare të ZPRK, standardet ndërkombëtare përcaktojnë kriteret specifike të cilat rregullojnë llojin e opinionit i cili mund të jepet. Opinioni i auditimit mund të jetë i pakualifikuar, i kualifikuar, i kundërt ose mund të jetë edhe mohim i opinionit (Cf. Aneksi 1 ISSAI 400).

VI. OPINIONI I AUDITIMIT

Sipas opinionit tonë Pasqyrat Financiare *prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale. Si theksim i çështjes Regjistri i Pasurive jo financiare nuk është shpalosur në pasqyra financiare (ISSAI 400 Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes)

VII. Të gjeturat dhe rekomandimet kryesore të auditimit

1. Rezultati Financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Shpenzimet e përgjithshme aktuale për vitin 2008 ishin 1,194,786 €. Krahasuar me buxhetin për 2008 ZPRK kishte shpenzuar rreth 45 % të buxhetit të planifikuar dhe në fund të vitit 2008 kishte një deficit prej 1,444,112 €.

Derisa lidhur me kategoritë ekonomike individuale ekziston një shumë e buxhetuar e pashpenzuar fare, kjo ka të bëjë me “Investimet Kapitale” në vlerë prej 1,100,000 €. Kjo shumë është e dedikuar për ndërtimin e rezidencës, që ende nuk ka filluar të realizohet ky projekt.

Konkluzioni

Sipas vlerësimit tonë ZPRK kishte shpenzuar buxhetin për vitin 2008 në kuadër të limiteve të përcaktuara nga Kuvendi me rastin e aprovimit të Buxhetit për vitin 2008.

2. Pasqyrat financiare

Sa u përket pasurive, kur kemi të bëjmë me sistem të kontabilitetit mbi bazë së parasë së gatshme, pasuritë jofinanciare duhet të shpalosen sipas Instruksionit Administrativ 2005/11, në Pasqyrat Financiare.

- Pasuritë jo financiare nuk janë paraqitur fare në pasqyrat financiare për vitin 2008;
- ZPRK nuk mban një Regjistër gjithëpërfshirës dhe të qartë të pasurisë fikse, ku do të paraqitet vlera e përgjithshme e pasurisë së saj.
- Regjistri i Pasurisë nuk ishte i harmonizuar me Regjistrin Kontabël për të siguruar që vlerat e inventarizimit përputhen.

Konkluzion

Ne vlerësojmë se mos evidentimi i plotë i pasurive jo financiare në regjistrat e brendshme të entitetit, si dhe mos shpalosja e duhur në Pasqyrat Financiare nuk ka ndikim në ndonjërin prej 3 Pasqyrave të Konsoliduara.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Sekretarin e përhershëm të ZPRK që të siguroj :

- Raportimin e plotë të të gjitha pasurive jo financiare duke i shpalosur në pasqyrat financiare, në pajtim me UA nr. 2008/13
- Inventarizimin mbi të gjithë pasurinë e saj dhe të harmonizoj rezultatet me regjistrat kontabël.

3. Realizimi i Buxhetit

3.1 Mallrat dhe Shërbimet

Shpenzimet e Telefonit në ZPRK

Të gjeturat :

Bazuar në vendimin e datës 01.06.2006 për caktimin e shumës së shpenzimeve për telefon fiks dhe mobil (roming) nga ZPRK, në mënyrë individuale ka tejkalime të ndjeshme të shpenzimeve. Në vitin 2008, prej 38 shfrytëzuesve të telefonisë fikse, 9 prej përdoruesve kanë tejkaluar shpenzimet e lejuara. Shuma e përgjithshme e tejkalimeve gjatë vitit është 1,706 €. Për më tepër në listën e telefonave fiks, 13 numra të telefonit janë të papërdorshëm, por për të cilët bëhet pagesa për taksë çdo muaj .

Edhe të shfrytëzimi i telefonisë mobile (roming) ka tejkalime po ashtu të ndjeshme. Vlera e tejkalimeve nëpër muaj arrin në 1,848 €. Madje ka rast kur për një muaj ka arritur vlera e shpenzimit deri në 389,77 € (korrik) prej një personi, kurse të lejuar ka 100 € në muaj, një zyrtar tjetër ka arrit vlerën e shpenzimeve për muajin nëntor 446,35 të lejuar e ka vlerën prej 100 € në muaj. Ka raste të zyrtarëve që furnizohen me mbushje telefoni dhe kanë të drejtën e shfrytëzimit edhe të telefonit mobil roming.

Konkluzioni

Shpenzimet e telefonisë janë të larta dhe mbi limitet e lejuara. Ato janë bërë në mënyrë të pa autorizuar dhe si të tilla kanë ndikuar në dëmtimin e BKK-së. Tejkalimi i shpenzimeve të telefonisë fikse dhe mobile (roming) ka ndodhur si pasojë e mos funksionimit efikas të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Sekretarin e ZPRK që të siguroj :

- Implementimin e plotë të rregullave në fuqi për përdorimin e telefonave nga zyrtarët e punësuar, si dhe shumatat e mbi paguara t'i kthehen BKK-së nga personat që i kanë shkaktuar këto shpenzime.
- Masa të menjëhershme për monitorimin e shpenzimeve të telefonit për të siguruar respektimin e limiteve të lejuara, derisa në rastet e tejkalimit të tyre të konsideroj marrjen e masave për rikthimin e shumave të mbi shpenzuara. Për t'u arritur ky objektivi rekomandohet angazhimi i Njësisë së Auditimit të Brendshëm të ZPRK dhe, në auditimin e radhës do të verifikojmë se sa është zbatuar ky rekomandim.

3.2 Prokurimi

Të gjeturat:

Në fushën e prokurimit kemi identifikuar disa raste ku procedurat e prokurimit, nuk janë në përputhje me kërkesat e Ligjit mbi Prokurim Publik të Kosovës Nr. 2003/17. Në veçanti kemi identifikuar se:

Janë aplikuar procedura me kuotim të çmimeve. Edhe përkundër faktit që shuma e shpenzimeve tejkalon vlerën 10.000 €, nuk janë zbatuar procedurat e hapura të prokurimit;

Përzgjedhja e operatorëve ekonomik, në katër lëndë të testuara nga auditorët është bërë në mungesë të tre operatorëve të përgjegjshëm.

Në katër lëndë të testuara, pjesëmarrës në komisionet obligative kanë qenë personat joadekuat.

Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve zyrtare “TOYOTA” të ZPRK

Zyrtari që ka bërë kërkesën për furnizim është kryesues i komisionit për vlerësim të ofertave dhe pranues i furnizimeve-shërbimeve.

Është bërë furnizim me artikuj që nuk kanë qenë në specifikacion teknik dhe që nuk janë në ofertën e kontraktorit, në këtë mënyrë janë bërë furnizime dhe pagesa të pa autorizuara. Shuma e këtyre pagesave të pa autorizuara është 3,650€ .

Rregullimi i llamarinës dhe polirimi i Automjeteve zyrtare “TOYOTA” të ZPRK

Kanë ofertuar 3 operator ekonomik (OE), dy prej të cilëve nuk e kanë pasur dokumentacionin e kompletuar dhe janë të pa përgjegjshëm. Megjithatë procedurat e kuotimit të çmimeve janë kryer.

Shërbime për mirëmbajtjen dhe servisimin e Automjeteve zyrtare “CHEVROLET Suburban” të ZPRK

Kryesuesi i Komisionit për vlerësim është parashtrues i kërkesës për shërbime dhe pranues i tyre. Dy zyrtar të njëjtë në të dyja Komisionet të Hapjes dhe vlerësimit.

Një nga operatorët ekonomik nuk e ka dorëzuar sigurimin e tenderit.

Kontrata e nënshkruar më datën 26.02.2008 është e pa qartë dhe e tipit kornizë, sipas çmimit për njësi. Në pikën 17.0 Vlera e kontratës për njësi është 7,465.64 €, ndërsa në pikën 17.1 çmimi për njësi (për një automjet) është 2,854.50 euro. Nuk është përdorur

forma standarde e Kontratave. Shuma e pagesave të kryera sipas 3 Urdhër Pagesave ka qenë: 18,370 €

Furnizim me Derivate të Naftës

Lënda për furnizim me derivate të naftës është e pakompletuar, mungon dokumentacioni i nevojshëm si:

- a) Kërkesa për përcaktimin e disponueshmëris së mjeteve;
- b) Vendimi për emërimin e komisionit për hapjen e ofertave;
- c) Procesverbali i shtypur dhe i nënshkruar nga zyra e prokurimit (një gjë e tillë është vetëm në fletore e shënuar me laps);

Operatorët ekonomik kanë qenë të papërgjegjshëm, pasi ju kanë munguar dëshmi të dokumentuara:

- d) "Patroni"- i mungon vërtetimi mbi pagesën e energjisë elektrike;
- e) "Menar Petrol" - i mungon Vërtetimi nga ATK;
- f) "Petrol Oti " Slovenija, Kompania Fituese, i mungon dëshmia mbi sigurimin e ekzekutimit të kontratës 10% nga vlera;

Furnizim me telefona mobil

Furnizimi me telefona mobil është paraparë në tri Lote. Përmbajtja e furnizimeve për telefona celular ka specifika tejet të avancuara, sasia për furnizim nuk është e përcaktuar.

Në komisionin për vlerësimin e ofertave dy zyrtar që janë furnizuar me telefona mobil janë edhe anëtar të komisionit, gjersa kryetari i komisionit të vlerësimit të ofertave nuk është zyrtar i ZPRK-së.

Kontrata e nënshkruar nuk ka të precizuar çmimin dhe sasinë e furnizimeve.

Shtypja e materialeve të konferencës shkencore me rastin e 130 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit

Prokurimi për punët përgatitore për manifestim: Lidhja Shqiptare e Prizrenit 1878-1881, është kryer me procedura për kuotimin e çmimeve. Këtu kemi devijim të procedurave standarde të prokurimit, kontratat që tejkalojnë vlerën mbi 10,000 € konsiderohet kontratë me vlerë mesatare.

Shërbimet për këtë aktivitet ndahen në dy kontrata të nënshkruara për një ditë dhe me të njëjtin operator ekonomik. Pagesa sipas kontratës me nr. Ref. ZPRK/08/074/236, është realizuar me vlerë prej 2.490.00€ dhe sipas kontratës së dytë me nr. Ref. ZPRK/08/075/236, është realizuar me vlerë prej 9,706.00€, gjithsej vlera e paguar 12.196.00€.

Konkluzioni

Ekziston një papajtueshmëri me kërkesat e Ligjit Nr. 2003/17 mbi Prokurimin Publik. Aplikimi i procedurave të kuotimit në vend të procedurave të hapura ndikon në limitimin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik Pjesëmarrja e personave të njëjtë si anëtarë të komisionit të hapjes, vlerësimin njëherit dhe pranimit të mallit, gjithashtu pjesëmarrja e kontraktorit për TI në komisione, paraqet konflikt interesi në ZPRK. Mandej realizimi i aktiviteteve të prokurimit vetëm me një operator të përgjegjshëm, mosrespektimi i çmimeve të kontraktuara si dhe furnizimi dhe pagesat e paautorizuara kanë të bëjnë me keqmenaxhim dhe me mundësinë e prezencës së mashtrimit.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë Sekretarin e ZPRK që të siguroj :

- Të respektohen dispozitat e LPP, të sigurohet konkurrencë dhe transparencë adekuate;
- Për kontratat që tejkalojnë vlerat mbi 10,000 € të zbatohen procedurat adekuate për prokurim;
- Anëtarët e komisioneve të përzgjidhen nga fushat kompetente që të mundësohet vlerësimi profesional i tenderëve;
- Të respektoj procedurat e prokurimit sipas rregullave në fuqi, duhet që kriteret e përcaktuara në dosjen e tenderit, t'i plotësojnë së paku tre ofertues, në mënyrë që operatorët të jenë të përgjegjshëm. Kjo do të kontribuonte në sigurimin e seriozitetit të furnizuesve në tender ;
- ZPRK do të duhej të mendoj të punësoj Zyrtar për mirëmbajtjen e TI, e jo të kontraktoj kompani të ndryshme për mirëmbajtjen e TI sepse kjo do t'i kushtonte Zyrës më pak dhe në aspektin e sigurisë së ruajtjes së të dhënave të ndjeshme të Zyrës është më mirë.
- Të mos lejohen furnizime dhe pagesa që nuk janë specifikuar dhe që nuk janë ofruar në çmimin e ofertës, të zbatohet Kontrata e nënshkruar.

3.3 Menaxhimi i pasurive

Instrukcioni Administrativ 2005/11 – Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare, kërkon që të bëhet sigurimi dhe menaxhimi efektiv i Pasurive Qeveritare. Megjithatë ne kemi konstatuar se:

Të gjeturat:

- Të gjitha pasuritë kapitale dhe jokapitale nuk evidentohen me vlerën e tyre blerëse;
- Procedurat e zhvlerësimit nuk zbatohen;
- Zyrtari i pasurisë nuk i ka marr hapat e nevojshëm për t'i azhurnuar të dhënat në regjistrin e pasurisë;
- Në Raportin e komisionit për inventarizim telefonat mobil të cilët janë në përdorim nuk evidentohen as nuk raportohen, zyrtarët e ZPRK furnizohen çdo dy vite me telefona mobil. Ka raste që të njëjtit zyrtar furnizohen me telefona mobil çdo vit. Telefonat e mëparshëm nuk kthehen;
- Një Komplet Pajisjesh për siguri në vlerë prej 350,690 € i blerë në vitin 2004 nuk është vënë në funksion dhe ruhet në depo në kushte shumë të dobëta;
- Nuk janë kompletuar dokumentet e nevojshme para regjistrimit;

Konkluzioni

ZPRK nuk kishte vepruar në bazë të kërkesave përkatëse të rregulloreve në lidhje me pasurinë e saj. Regjistrat e pasurisë nuk janë të sakta dhe të kompletuara. Si rezultat, ZPRK nuk ka kontroll të mjaftueshme mbi pasurinë e saj, gjë që e rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të saj.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Sekretarin e përhershëm të ZPRK që të siguroj:

- Të veprohet në përputhje me IA 2005/11– Menaxhimi dhe Regjistrimi i Pasurive Qeveritare;
- Zyrtari i pasurisë në mënyrë urgjente, të bëjë konsolidimin e regjistrave të pasurisë dhe të azhurnohet regjistri kontabël. Çdo pasurie, t'i vihet numri identifikues.
- Menaxhmenti i ZPRK-së të sigurohet që zyrtari i pasurisë, evidenton dhe klasifikon saktë të gjitha pasuritë që janë në dispozicion dhe që blihen dhe të bëhet zhvlerësimi i tyre sipas IA 2005/11.
- Pajisjet e sigurisë që mbahen në depo që nga viti 2004 në kushte të dobëta, të vihen në përdorim sa më shpejt ose tu sigurohen kushte më të mira sepse në ato kushte mund të dëmtohen dhe prishen.
- Të respektohet shkalla e shlyerjes së telefonave dhe të pengohet blerja e telefonave më shpesh sesa është e lejuar.

- Hedhja e pasurisë jashtë përdorimit të bëhet nga komisioni i veçantë për çregjistrimin e pasurisë.

3.4 Menaxhimi i Automjeteve dhe gjeneratorëve

Të gjeturat

ZPRK posedon 25 automjete dhe dy gjenerator. Menaxhimi dhe përcjellja e shpenzimeve të automjeteve, bëhet përmes zyrtarit të njësisë së transportit. Ne nuk kemi mundur të bëjmë krahasimin me normativin e shpenzimeve të litrave nga dokumentacionet teknike të veturave dhe nga tabelat e përpiluara të zyrtarit të njësisë së transportit. Ne kemi bërë krahasimet vetëm në bazë të dokumenteve ekzistuese të dy automjeteve dhe nga kjo shihet se regjistrimi i kilometrave të kaluara të automjeteve bëhet vetëm në bazë të Targave të regjistrimit. Presidenca zbaton një politikë të posaçme (por jo të shkruar) të përdorimit të automjeteve. Nga kjo formë e evidencës nuk mund të kuptohen të dhënat e sakta të përdorimit të automjeteve.

Dokumentet teknike të përdorimit të automjeteve nuk janë në harmoni me tabelat e përpunuara nga njësia e transportit nga të cilat duhej të nxirren këto rezultate .

ZPRK posedon në listën e pasurive edhe 2 gjenerator. Ne kemi bërë përpjekje të sigurojmë informata të plota lidhur me gjeneratorët, por kemi siguruar vetëm faturën e blerjes së gjeneratorit dhe 3 fletëdërgesave të karburanteve. Nuk ka të dhëna tjera që tregojnë për normativin e gjeneratorit. Nuk raportohet fare për orët e punës së gjeneratorit e as për shpenzimet e derivateve.

Konkluzioni

Hartimi i politikave organizative të brendshme për menaxhimin e automjeteve do të ndikonte dhe siguronte një menaxhim më efikas të automjeteve.

Raportimi në bazë të targave të regjistrimit nga ana e shfrytëzuesve të automjeteve, ka paraqitur vështirësi në kontrollin e shpenzimeve dhe përcaktimit të saktë të kilometrave të kaluara. Bazuar në to, raportet e njësisë së transportit nuk janë complete dhe të sakta .

Mos raportimi mbi të dhënat e orëve të punës dhe shpenzimit të derivateve për gjenerator krijon konfuzitet në raportimet e njësisë së logjistikës.

Rekomandimi 4.1

Rekomandojmë Sekretarin e ZPRK-së që të siguroj :

- Të përpilohen politika të brendshme organizative për përdorim të automjeteve;
- Duhet të vendosen procedura të aprovuara nga njësia e transportit (drejtoria e administratës), që do të obligonin të gjithë shfrytëzuesit e automjeteve, që në çdo periudhë mujore të bëhet ekzaminimi fizik i kilometrave të kaluara, jo në bazë të

targave të regjistrimit, por në bazë të llojit të automjetit përkatës. Këto të dhëna mandej do të shërbenin për analizimin më të saktë të shfrytëzimit të karburanteve;

- Shpenzimet e derivateve për automjete dhe orët e punës së gjeneratorëve të raportohen në baza mujore.

4. Sistemet e Kontrollit të brendshëm

Një sistem adekuat i kontrollit të brendshëm siguron një proces të dizajnuar në atë mënyrë që të ofrojë siguri të arsyeshme për arritjen e objektivave në kategoritë e mëposhtme:

- Efektivitetin dhe efikasitetin e operacioneve
- Besueshmërinë e raportimit financiar
- Përputhshmërinë me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme

Kemi konstatuar se sistemi i kontrollit të brendshëm i ZPRK nuk ofron siguri të arsyeshme që është duke i arritur objektivat e përcaktuara. Në veçanti, kjo është reflektuar më së shumti tek gjendja në lidhje me pasuritë dhe aktivitetet e prokurimit, ku nuk janë respektuar rregulloret dhe ligjet në fuqi. Shembuj të veçantë të mangësive të konstatuara gjatë auditimit paraqiten në vijim:

- Mbajtja jo e saktë e të dhënave në regjistrin e pasurive dhe regjistrin kontabël, pasuritë nuk evidentohen me vlerën e tyre blerëse, regjistrat nuk azhurnohen, nuk është kompletuar dokumentacioni i nevojshëm për regjistrimin e pasurive;
- Është vërejtur dobësi në kontrollin e brendshëm në aspektin e mënyrës së kërkesës dhe specifikimit për furnizim me tel. mobil. Nuk ka politika të shkruara për mënyrën e furnizimit të telefonave mobil.
- Në kundërshtim me ligjin mbi prokurimin publik, është identifikuar konflikt i interesit, meqë ka raste kur personat pjesëmarrës në Komisionin e hapjes janë të njëjtët që kanë marrë pjesë edhe në Komisionin e Vlerësimit, dhe kanë pranuar mallin. Konflikt i ngjashëm interesi është identifikuar në rastet që ka qenë kryesues ose anëtarë i komisionit të vlerësimit personi që nuk punon fare në ZPRK. Ai është kontraktor për TI, dhe për vitin 2008 ka lidhur 5 kontrata me ZPRK;
- Në disa raste aktivitetet e prokurimit janë realizuar me operator ekonomik të papërgjegjshëm;
- Në disa raste janë aplikuar procedurat me kuotim të çmimeve përkundër faktit që shuma e shpenzimeve tejkalon vlerën 10.000 €, nuk janë zbatuar procedurat e hapura të prokurimit;
- Janë bërë pagesa të paautorizuara.

Konkluzioni

ZPRK nuk vepron në përputhshmëri me rregulloret dhe procedurat e përcaktuara në lidhje me pasuritë dhe prokurimin, nuk ka të krijuar një sistem më të mirë të kontrollit të brendshëm që do të siguronte menaxhim të drejt të pasurive, prokurimeve, si dhe raportim të saktë financiar.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Sekretarin e ZPRK që të siguroj :

- ZPRK duhet të krijojë dhe të mbajë një sistem të kontrollit të brendshëm efikas dhe efektiv për të realizuar në mënyrë të suksesshme aktivitetet operative. Kjo, krahas zbatimit rigoroz të ligjeve, do të ishte e nevojshme edhe përgatitja e akteve të brendshme (rregulloret, urdhëresat administrative, udhëzimet, etj).
- Sistemi i kontrollit të brendshëm duhet të jetë nën mbikëqyrjen e vazhdueshme të menaxhmentit që të konfirmohet se funksionon siç parashihet dhe që të modifikohet në mënyrë të duhur në rast ndryshimi të kushteve.

Shtojca 1

Llojet e ndryshme të Opinioneve të Auditimit të zbatuara nga ana e ZAP në Raportet Vjetore të Auditimit për vitin 2009 (e shkëputur nga ISSAI 400)

9. Një opinion i auditimit normalisht është në format standard, ndërlidhur me pasqyrat financiare si tërësi, duke shmangur nevojën për caktuar gjatësinë e saj por duke bartur sipas natyrës së saj një kuptim të përgjithshëm tek lexuesit sipas kuptimit të saj. Natyra e këtyre fjalëve do të ndikohet nga korniza ligjore të auditimit, por përbërja e opinionit duhet të tregoj qartë a është i pakualifikuar apo i kualifikuar, apo nëse është i kualifikuar në disa çështje të caktuara apo është opinion i kundërt (paragrafi 14), apo është mohim i opinionit (paragrafi 15).

10. Një opinion i pakualifikuar jepet kur auditori është i kënaqur në të gjitha aspektet materiale që:

- (a) pasqyrat financiare janë përgatitur duke shfrytëzuar baza dhe politika të pranuar të kontabilitetit të cilat janë zbatuar në mënyrë konsistence (të qëndrueshme);
- (b) pasqyrat janë në pajtim me kërkesat statusore dhe rregulloret relevante;
- (c) pamja e paraqitur në pasqyrat financiare janë përputhje me njohuritë e auditorit në lidhje me entitetin e audituar; i
- (d) është një shpalosje adekuate e të gjitha çështjeve materiale relevante për pasqyrat financiare.

11. Theksi i çështjeve. Në disa rrethana auditori mundet të konsideroj se lexuesi nuk do të kuptoj në mënyrë të duhur pasqyrat financiare nëse vëmendja është përqendruar në çështje të pazakonshme apo të rëndësishme. Si një rregull e përgjithshme, auditori kur jep një opinion të pakualifikuar kjo nuk i referohet ndonjë aspekti specifik të pasqyrave financiare në opinionin e tij në rast se kjo mund të interpretohet gabimisht si opinion i kualifikuar. Me qëllim të shmangies së kësaj përshtypjeje, referencat që janë menduar si nënvizim i çështjes; gjinden në paragrafët e ndara nga opinionin. Sidoqoftë, auditori nuk duhet të përdor nënvizimin e çështjes për të përmirësuar mungesën e shpalosjeve të duhura në pasqyrat financiare apo si alternativ, zëvendësim për kualifikim të opinionit.

12. Auditori mund të mos jetë në gjendje të shpreh një opinion jo të kualifikuar kur ekziston një nga ato rrethana dhe në gjykimin e auditorëve, afektin e tyre është ose mund të jetë materiale për pasqyrat financiare:

- (a) ka pasur limitime në fushëveprimin e auditimit
- (b) Auditori konsideron që pasqyrat janë jo komplete apo çorientues apo ekziston një ndarje e pajustificuar nga standardet e pranueshme të kontabilitetit; apo
- (c) Ekzistojnë paqartësi që ndikojnë në pasqyrat financiare.

13. Opinioni i Kualifikuar. Aty ku auditori nuk pajtohet apo nuk është i sigurt në lidhje me një ose me tepër artikuj të veçantë në pasqyrat financiare e që janë materiale por jo edhe fundamentale në kuptimin e pasqyrave, duhet të jepet një opinion i kualifikuar.

Formulimi i opinionit normalisht tregon një rezultat të kënaqshëm ndaj subjektit të audituar, sa i përket një pasqyre të qartë dhe koncize, të çështjeve të mospajimit apo edhe të paqartësive që ngrisin opinion e kualifikuar. I ndihmon përdoruesit e pasqyrave nëse efekti financiar i

paqartësisë apo edhe i mosmarrëveshjeve është përcaktuar nga ana e Auditorit edhe pse kjo nuk është gjithmonë praktike apo relevante.

14. Opinions i Kundërt. Aty ku Auditori nuk ka mundësi të jap një opinion mbi pasqyrat financiare në tërësi, për shkak të mosmarrëveshjeve që është aq thelbësore ngase e minon pozitën e prezantuar në vazhdim që opinionin që kualifikohet në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, atëherë jepet opinion i Kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë e bën të qartë se pasqyrat financiare nuk janë prezantuar në mënyrë të drejtë, duke specifikuar qartë dhe në mënyrë koncize të gjitha çështjet e mosmarrëveshjeve. Përsëri, është një ndihmesë që efekti financiar mbi pasqyrat financiare përcaktohet aty ku duhet dhe është praktik.

15. Mohimi i Opinionit. Aty ku Auditori nuk mund jep opinion në lidhje me pasqyrat financiare, të marrë si tërësi për shkak të paqartësisë apo restriksione të fushëveprimit që është thelbësor që një opinion që është i kualifikuar në aspekte të caktuara nuk do të jetë adekuat, jepet opinion i kundërt. Formulimi i një opinionin të tillë të kundërt a bën të qartë që një opinion nuk mund të jepet, duke specifikuar në mënyrë të qartë dhe koncize të gjitha çështjet e paqarta.

16. Është bërë zakon që ILA të ofrojnë një raport të detajuar për të plotësuar opinion në rrethana në të cilat është e pamundur të jepet një opinion jo i kualifikuar.

Shtojca II: Komentet e ZPRK dhe Përgjigja e ZAP-it ndaj Komenteve

Komentet e ZPRK	Përgjigja e ZAP																								
<p>Prokurimi</p> <p>Ne auditimin e bere' ne ZPRK-es, ku verifikimet te Prokurimi janë bere ne rreth 60% te blerjeve, ZAP me siguri ka vërejtur se ZPRK-es, ka ndërmarrë hapa serioz drejte reduktimit te shpenzimeve, por duke mos e rrezikuar funksionimin e Zyrës. Përveç një rasti te një gabimi teknik, i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga ju gjendet ne dosje te prokurimit.</p>	<p>Analiza krahasuese e shpenzimeve për vitin 2008 dhe 2007</p> <table border="1" data-bbox="1037 451 1906 646"> <thead> <tr> <th></th> <th>2008</th> <th>2007</th> <th>Diferenca</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Paga dhe Mëditje</td> <td>178,575</td> <td>254,533</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Mallrat dhe Shërbimet</td> <td>975,174</td> <td>779,057</td> <td>196,117</td> </tr> <tr> <td>Shërbimet Publike</td> <td>25,287</td> <td>29,051</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Transferet dhe Subvencionet</td> <td>15,750</td> <td>7,875</td> <td></td> </tr> <tr> <td>Gjithsej</td> <td>1,194,786</td> <td>1,070,517</td> <td>124,269</td> </tr> </tbody> </table> <p>Nga tabela më lart shihet se ZPRK për vitin 2008 kishte shpenzuar 196,117 € për mallra dhe shërbime më shumë se sa për vitin 2007, ose gjithsej shpenzimet për vitin 2008 janë më të larta nga viti 2007 për 124,269 €.</p>		2008	2007	Diferenca	Paga dhe Mëditje	178,575	254,533		Mallrat dhe Shërbimet	975,174	779,057	196,117	Shërbimet Publike	25,287	29,051		Transferet dhe Subvencionet	15,750	7,875		Gjithsej	1,194,786	1,070,517	124,269
	2008	2007	Diferenca																						
Paga dhe Mëditje	178,575	254,533																							
Mallrat dhe Shërbimet	975,174	779,057	196,117																						
Shërbimet Publike	25,287	29,051																							
Transferet dhe Subvencionet	15,750	7,875																							
Gjithsej	1,194,786	1,070,517	124,269																						
<p>Komenti nr . 1</p> <p>I. Mirëmbajtja dhe Servisimi i Automjeteve,"Toyota" te ZPRK-ës, Nr. Prokurimit 08/007/221.</p> <p>Përkritazi me këtë tender thuhet se nuk kanë poseduar dokumente complete gjendja është siç vijon: Nga tri kompani te përgjegjshme kane dorëzuar këto dokumente te kërkuara:</p> <p>I.'Siqani' Prishtine ka dorëzuar këto dokumente:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Certifikatën e Biznesit nr. 80288867 b) Certifikatën e TVSH -ës nr. 3003532 c) Certifikatën e ATK pjesa e obliguar nr. 80288867 d) Fatura e KEK -ut nr. 5628023 me urdhër pagese te dt. 05,02,2008 e) Deklarata nen Betim për përshatshmëri me dt. 	<p>Rekomandimi nr. 1</p> <p>Këto dokumente gjatë auditimit tonë nuk na janë ofruar, përkundër insistimit tonë që t'i sjellin, Zyrtarët e prokurimit na janë përgjigjur se nuk po mund t'i gjejnë ato dokumente. Kjo dëshmon se sa azhurnohen dhe ruhen dokumentet në këtë sektor. Dokumentacioni i ZPRK-së nuk radhitet dhe nuk ruhet si duhet. Këtë e pranoni edhe vetë në komentin tuaj. Sidoqoftë ne i pranojmë këto dëshmi si relevante dhe ky konstatim hiqet nga raporti.</p>																								

11,02,2008 f) Garancioni bankar BEP NR. 0706 i dt.08,02,2008 me vlere 1000,00€

2."Global" Prishtine ka dorëzuar keto dokumente:

- a) Certifikatën e biznesit nr. 70209846
- b) Certifikatën e TVSH-es nr. 3004320
- c) Certifikatën e ATK-ës pjesa obliguar nr. 70209846
- d) Fatura e KEK-ut me dt .07,02,2008 me urdhër pagese borxh 14,€.
- e) Deklarata nen Betim për përshtatshmëri me dt. 11,02,2008.
- f) Garancioni Bankar BPB DT. 08,02,2008 me vlerë 1000,00€ dhe

3."ShPK AutoTrade" Prishtinë ka dorëzuar këto dokumente:

- a)Certifikatën e biznesit nr. 70023918
- b)Certifikatën e TVSH-ës nr. 3004331
- c) Certifikatën e ATK-ës pjesa e obliguar nr. 70023918
- d)Fatura e KEK-ut te dt,06,02,08 dhe urdhër pagese me borgj 5€. e)Deklarata nën Betim për përshtatshmëri me dt. 1 1,02,2008
- f) Garancioni bankar BPB nr. G0008/48 dt 08,02,2008 me vlerë prej 1000,00€

Në bazë të dokumentacionit në lëndët të cilat i keni kontrolluar jemi të mendimit se të tri kompanitë (Operatoret Ekonomik) kanë qenë complete dhe te përgjegjshme për sa i përket pikës së parë të vërejtjeve.

Për pikën e dytë:

Kryetari i komisionit për vlerësim që njëherit ka qenë edhe parashtrues i kërkesës për furnizim nuk paraqet konflikt interesi, pasi që ai që e udhëheq rastin ma se miri i njeh natyrën

Parashtruesi i kërkesës për shërbime, që është kryesues i komisionit për vlerësim dhe njëherit edhe pranues i këtyre shërbimeve tregon

<p>e punës. Për pikën e tretë: Furnizimi i disa pjesëve të bëra të cilat nuk kane qene te parapara ne specifikim teknik Nuk ka mundësi që të parashihen të gjitha prishjet dhe përshkrimi i tyre që në total përbejnë mbi 10,000 pjesë.</p>	<p>për mosrespektim të ndarjes së detyrave dhe paraqet konflikt interesi. Furnizimet jashtë specifikacionit teknik, nuk janë me procedura të prokurimit dhe nuk lejohen . E gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron .</p>
<p>Komenti nr. 2 2. Rregullimi i llamarinës dhe polirimi i automjeteve zyrtare „Toyota, te ZPRK. Për këtë lëndë pajtohem me mangësitë e vërejtura nga ana e AP.</p>	<p>Rekomandimi nr. 2 E gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron .</p>
<p>Komenti nr. 3 3,Shërbime për mirëmbajtjen dhe servisimin e Automjeteve zyrtare "Chevrolet Suburban" te ZPRK. Pika e parë e vërejtjeve se Kryesuesi i komisionit për vlerësim është' edhe paraqitësi i kërkesës për furnizim nuk paraqet konflikt te interesit. Pika e dyte e vërejtjes se dy anëtar te komisionit të vlerësimit kanë qenë edhe në komisionin për hapje nuk mund të ketë kurrfarë konflikt interesi . Ndërsa për pikën e tretë pajtohem në lëshimin e bërë pasi që është e mundur që me rastin e hapjes së tenderit sigurimi i ofertës ka qene, por pas nënshkrimit të kontratës Operatori ekonomik ka munde te tërëhjek garancionin bankar për të cilin nuk kemi dëshmi.</p>	<p>Rekomandimi nr. 3 Ne kemi shqyrtuar komentet e ZPRK dhe vlerësojmë se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të ndryshuar gjetjet apo konkluzionet tona të auditimit.</p>
<p>Komenti nr. 4 4. Furnizimi me derivate të naftës. Pika e parë. a)Kërkesa për përcaktueshmërinë e disponueshmëris së mjeteve: Nevoja e madhe për furnizim me derivate te naftës dhe</p>	<p>Rekomandimi nr. 4 Komentet e menaxhmentit nuk janë percjellur me dëshmi përkatëse, në mënyrë që të ketë bazë për ndryshimin e mendimit tonë.</p>

<p>mungesa e mjeteve në fillim të vitit na ka detyruar që me lejimin e sekretarit të zyrës të bëjmë këtë furnizim, ekziston shkresa e lejitimit të furnizimit nga Sekretari i ZPRK-ës. Pika e dytë .</p> <p>b)Ekziston proces verbali për komisionin e hapjes se ofertave i dt. 19,02,2008 i nënshkruar nga komplet komisioni për hapjen publike me këtë rast është nënshkrimi i pjesëmarrësit te OE „Oti Petrol „Hysen Kutllovci. Pika e tretë.</p> <p>c)Procesverbali është i shënuar ne fletoren kryesore të Prokurimit. Pika e katërt.</p> <p>d)OE "Patroni" nga Prishtina, nuk kemi munde ta gjejmë faturën për pagesën e KEK-ut Pika e pestë.</p> <p>e) OE "Menar PetrolP' Nuk e kemi gjetur vërtetimin e ATK-ës. Pika e gjashte.</p> <p>3 f)Mungesa e sigurimit te ofertës per furnizimin e ketyre artikujve, ne rast te mos për mbushjes se kontratës, munde te pasoj ndërprerja e saje, dhe ne si Autoritet Kontraktues nuk humbim asgjë. Vlen te theksoj se ky tender është shpallur për të tretën herë.</p>	<p>E gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron .</p>
<p>Komenti nr. 5 5. Furnizimi me telefona mobil. Pika e parë. Furnizimi me telefona mobil është bërë në bazë' te aprovimit të sekretarit i cili në bazë të kompetencave të veta sipas Rregullores të Unmikut 2004/6, neni 2. 2.</p>	<p>Rekomandimi nr. 5 Komentet e menaxhmentit janë vetëm sqarime por jo me mbështetje (dëshmi) faktike, për më tepër e gjetura jonë në këtë rast ka të bëjë edhe me faktin që kontrata e nënshkruar nuk ka të precizuar çmimin dhe sasinë e furnizimeve .</p>

<p>Pika e dytë. Furnizimi i dy anëtarëve të komisionit me telefona mobil nuk paraqet asnjë problem nga se po ata anëtar kanë paraqitur kërkesën për furnizim me herët. Dhe lidhur me këtë nuk paraqet ndonjë konflikt interesi.</p> <p>Pika e tretë. Kryetari i komisionit për vlerësimin e ofertave është emëruar si ekspert, është Profesional, ing.dipl.informatikës dhe mirëmbajtës i IT-se, në ZPRK.</p>	<p>E gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron .</p>
<p>Komenti nr. 6 6. Shtypja e materialeve të konferencës shkencore me rastin e 130 vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Ka qenë rast urgjent. Pra për shkaqe të urgjencave dhe specifikave nuk kemi pas mundësi për procedura të hapura me vlerë mesatare. Dëshmi, shih kopjet</p>	<p>Rekomandimi nr. 6 Ne kemi shqyrtuar komentet e ZPRK ku paraqiten arsyet e moszbatimit të procedurave të hapura dhe vlerësojmë se nuk ka dëshmi të mjaftueshme për të ndryshuar gjetjet apo konkluzionet tona të auditimit</p>
<p>Komenti nr 7 Faqe 9 Konkluzion</p> <p>1. Nuk qëndrojnë konkluzionet, nuk është konstatim profesional se ZPRK nuk ka kontroll të mjaftueshme mbi pasurinë e saj . Vetë verifikimi i të gjitha mostrave të pasurisë të bëra nga auditorët ka rezultuar se tërë pasuria ekziston dhe shfrytëzohet nga ZPRK dhe se nuk ka asnjë mungesë.</p> <p>Shih Tabelën e kërkesave për verifikim të pasurisë.</p> <p>ZPRK ka të regjistruara pasuritë në një program në EXEL, kurse tani pas blerjes së një softveri me një çmim prej 1,550 €, gjë që është shumë më i ultë se softuerët tjerë të ngjashëm, si</p>	<p>Rekomandimi nr 7</p> <p>Gjatë verifikimit tonë të pasurive, jo të gjitha pasuritë janë në vend. Telefonat e blerë gjatë vitit 2008 disa Zyrtar nuk i kishin me vete apo kishin të tjerë nga ata që ka blerë ZPRK. Ndërkaq as telefonat e vjetër nuk i kishin kthyer për tu furnizuar me të rinj. Pajisjet që nuk janë në përdorim nuk ruhen në kushte adekuate.</p> <p>Komenti i dytë nuk është relevant për auditimin tonë. Pasuritë publike duhet të menaxhohen, ruhen dhe regjistrohen sipas</p>

<p>psh te paguar (nga entitete tjera) prej 8,640 € , po bënë regjistrimin e pasurisë sipas UA 2005/11</p> <p>Dëshmi: shih Publikimin e dhënies së tenderit mbi çmimet krahasuese</p>	<p>Instrukcionit administrativ 2005/11 për menaxhimin dhe regjistrimin e pasurive qeveritare</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron .</p>
<p>Komenti nr 8 Faqe 11, Konkluzion</p> <p>Nuk ka kurrfarë konflikt të interesit sa i përket pjesëmarrësve në komisione, sepse te njëjtit nuk kane kurrfarë lidhje biznesore por as lidhje familjare me ofertuesit. Në rastet e angazhimit të personave qe nuk punojnë ne ZPRK, por janë të punësuar te kontraktor tjerë, si psh ai i TI, nuk paraqet kurrfarë konflikt interesi, sepse i njëjti person ka qenë në komisione si anëtarë dhe në cilësi të ekspertit, dhe se në këto tenderë, kompania ku punon ky person, nuk ka konkurruar fare. Pjesëmarrja e personave jashtë' ZPRK-ës, bëhet në rastet e angazhimit si ekspert dhe nuk është e ndaluar me ligj.</p>	<p>Rekomandimi nr 8</p> <p>Kontraktorët e Zyrës së Presidentit NUK kanë të drejtë të marrin pjesë në asnjë komision të ZPRK. Ata janë të thirrur që të kryejnë vetëm obligimet e tyre furnizuese dhe/apo shërbyese sipas kontratës që kanë. Pjesëmarrja e tyre në aktivitete prokurimi paraqet drejtpërdrejt konflikt interesi. Kompania e këtij përfaqësuesi gjatë vitit kishte 4 (katër) kontrata me ZPRK-në</p> <p>Për vlerësimin e ofertave për përgatitjen e shënimit të përvjetorëve dhe për furnizim me medalje nuk është çështje e teknologjisë informative dhe nuk nevojitet ekspert i TI-së.</p> <p>Konstatimet tona mbesin krejtësisht të njëjta, Sekretari i Përhershëm udhëzohet të ndër marr masa adekuate që këto në të ardhmen mos të përsëriten</p>
<p>Komenti nr 9 Rekomandimi 2, pika 6, faqe 12</p> <p>ZPRK-ës, ka bërë edhe një analizë të përfitimeve buxhetore, sa i përket mirëmbajtjes së TI, duke lënë mënjane modelin qe e ka rekomanduar ZAP, sepse : ZPRK-ës, ka pasur një kontraktor me një shumë mujore prej 9.976.45 €, kurse tani mesatarja mujore e shpenzimeve është 700 Euro.</p> <p>Sikur të punësonte së paku 2 të punësuar (<i>administratori</i>: 304 € paga + shtesa 400 € =704 €, plus kontributet pensionale, dhe një <i>menaxher</i> psh, 322.30 € + shtesa 400 € =722.30 €) me pagesë dhe shtesa të parapara me</p>	<p>Rekomandimi nr 9</p> <p>Menaxhmenti i ZPRK-së duhet të mendoj më shumë në sigurinë e të dhënave të ZPRK, që janë çështje shtetërore dhe të mos bëhet e varur nga operator ekonomik dhe nga sistemi i teknologjisë informative që ata imponojnë, sepse kjo mund të shkaktoj ndonjë lloj shantazh në të ardhmen në rast se nuk iu vazhdohet kontrata.</p> <p>ZPRK duhet të ketë sistemin e vet informativ, të cilin duhet ta administrojnë Zyrtarët e ZPRK, të cilët i nënshtrohen Kodit të etikës dhe mirësjelljes së shërbyesve civil. ZPRK gjatë vitit 2008 për këtë qëllim ka shpenzuar 38,278 € dhe llogaritjet e analizat tuaja nuk janë bindëse dhe relevante për ta ndryshuar konstatimin e</p>

<p>Vendim të Qeverisë së Kosovës, do të ishte pra rreth 1500€ ne muaj , dhe ne rast të komplikimeve, kontraktori i merr përsipër te evitohet çdo defekt, pamarre parasysh, a do të angazhojë edhe specialist të shumtë .</p> <p>Pra këtu shihet se sa janë reduktimet e shpenzimeve nga metoda e përdorur tani.</p> <p>Dëshmi :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1 . Fatura e ish kontraktorit " INET" për një muaj, prej 9,976.45 € 2. Fatura e kontraktorit aktual " ISOFT" për një muaj prej 700.00 € 3. Normativi për pagesë të ekspertëve të IT, sipas vendimit të Qeverisë së Kosovës. 	<p>auditorit</p> <p>E gjetura dhe rekomandimi janë qëndron .</p>
<p>Komenti nr 10 Shpenzimet e telefonit faqe 12, Tejkalimet për tejkalime të shpenzimeve të telefonisë që janë konstatuar nga ZAP, kanë të bëjnë me shpenzimet e vizitave zyrtare, që personat e caktuar i kanë bërë jashtë vendit, këto janë shpenzime zyrtare. Nuk qëndron konstatimi se është dëmtuar BKK dhe se kontrolli i brendshëm nuk ka funksionuar . Kjo shihet nga reduktimi i shpenzimeve të telefonisë nga 63,619 €, në vitin 2007, në 38,615 € në vitin 2008</p>	<p>Rekomandimi nr 10 Siç kemi cekur në të gjeturën tonë, ne jemi bazuar në vendimin e datës 01.06.2006 për caktimin e shumës së shpenzimeve për telefoni fikse dhe mobil(roming) nga ZPRK, dhe e gjetura janë nuk vë në dyshim karakterin e shpenzimit, por tejkalimin e tyre. Ne nuk jemi njohur me ndonjë vendim tjetër nga ZPRK që i arsyeton tejkalimet e shpenzimeve të tilla . Megjithatë edhe komentet e menaxhmentit nuk janë percjellur me dëshmi përkatëse, në mënyrë që të ketë bazë për ndryshimin e mendimit tonë. E gjetura dhe rekomandimi janë qëndron.</p>
<p>Komenti nr 11 Faqe 15, Logjistika -Menaxhimi dhe percjellja e shpenzimeve të karburanteve ZPRK-ës, për çdo autoveturë ka mbajtur evidencë mbi shpenzimet mujore të derivateve. Ne dy rastet që ZAP i ka verifikuar, kanë pasur të bëjnë me autoveturat që voziten nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe të cilët për shkaqe sigurie kanë ndërruar tabelat e autoveturave në disa raste, për të cilat vete auditorët e ZAGJ janë sqaruar nga vetë</p>	<p>Rekomandimi nr 11 Komentet e menaxhmentit lidhur me logjistikën më shumë japin vetëm një vështrim të disa krahasimeve analitike të shpenzimeve ndërmjet periudhave vjetore, gjersa të gjeturat tona kanë të bëjnë me menaxhimin e sektorit të logjistikës për vitin aktual 2008. Nuk janë ofruar dëshmi shtesë që do ta arsyetonin ndryshimin e të gjeturës dhe rekomandimit tonë ,andaj</p>

<p>pjesëtari i Policisë së Kosovës, andaj konstatimi i ZAP, se sasitë e shpenzuara nuk janë të sakta nuk qëndron, sepse :</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shpenzimet për derivate në vitin 2007 ishin 74,951 €, kurse në vitin 2008 janë 61,958 € 2. Shpenzimet për regjistrimi dhe sigurimi i automjeteve në vitin 2007 ishin 64,594 €, në vitin 2008 janë 25,051€ 3. Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe riparimi i automjeteve në vitin 2007 ishin 108,706 € ndërsa në vitin 2008 janë 61,711 € 4. Dëshmi: Fletë raportimet mujore për shpenzimet derivateve të naftës <p>* Shpenzimet e derivateve për gjenerator: Njëri gjenerator nuk është furnizuar asnjëherë me derivate nga ZPRK-ës, kurse tjetri që përdoret nga pjesëtarët e sigurimit të Policisë së Kosovës në rezidencën e Presidentit, ka këto shpenzime: 1,478 litra dhe 1,822 €.</p> <p>Dëshmi: Faturat e shpenzimeve</p>	<p>e gjetura dhe rekomandimi jonë qëndron.</p>
---	--